Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Grafikë**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**3**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**6**
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë trajtohen parimet themelore, mjetet dhe teknikat e grafikës tradicionale dhe digjitale. Studentët njihen me proceset e shtypit të lartë, shtypit të rrafshët, shtypit të thellë dhe shtypit depërtues, si dhe me aplikimin e tyre praktik në realizimin e kompozimeve grafike. Vëmendje e veçantë i kushtohet teknikës së linocut si formë klasike e grafikës së shtypit të lartë, ndërsa theksi kryesor vendoset në zhvillimin e kompetencave në grafikën digjitale dhe ndërveprimin midis proceseve tradicionale dhe atyre bashkëkohore vizuale.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është zhvillimi i kompetencave teorike dhe praktike në fushën e grafikës, duke aftësuar studentët në përdorimin kritik dhe krijues të teknikave tradicionale të shtypit dhe proceseve digjitale bashkëkohore, si dhe në ndërlidhjen konceptuale dhe teknike ndërmjet tyre.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të: • Shpjegojë dhe analizojë parimet themelore, mjetet dhe teknikat e grafikës tradicionale dhe digjitale. • Aplikojë teknikën e linocut në realizimin e një kompozimi grafik të strukturuar. • Zhvillojë dhe realizojë një projekt grafik duke integruar konceptin artistik me zgjidhjen teknike.

	• Krahasojë dhe ndërthurë proceset tradicionale të shtypit me teknikat digjitale bashkëkohore. • Argumentojë dhe prezantojë në mënyrë kritike punën e realizuar.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	8	16
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	5	8	40
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1	3
Projektet, prezentimet, etj	2	4	8
Totali			**150**

Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata, punë individuale, punime me detyra për çdo javë, diskutime, punë në grupe.
Metodat e vlerësimit:	70% Punime Praktike 10% Prezantim 20% Provim final
Literatura	
Literatura bazë:	Graphic Arts Hardcover – October 1, 2010 by A.A.V.V. (Author)
Literatura shtesë:	Beginner's Guide to Linocut Paperback – December 4, 2018 by Susan Yeates

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**

Java e parë:	Hyrje në grafikë*: koncepti, historia e shkurtër e shtypit grafik dhe klasifikimi i teknikave (shtypi i lartë, i thellë, i rrafshët, depërtues).*
Java e dytë:	Linogdhendja/Linocut – *parimet bazë dhe shembuj historikë e bashkëkohorë*
***Java e tretë*:**	*Mjetet, materialet dhe organizimi i hapësirës së punës*
Java e katërt:	*Zhvillimi i konceptit dhe kompozimi në grafikë (nga ideja te skica)*
Java e pestë:	*Përgatitja e vizatimit për transferim në lino.*
***Java e gjashtë*:**	*Teknikat e prerjes (siguria, kontrolli i vijës, kontrasti pozitiv/negativ).*
Java e shtatë:	*Procesi i printimit – prova e parë (proof print) dhe korrigjimet.*
Java e tetë:	*Realizimi i edicionit grafik dhe analizë kritike e punimeve.*
Java e nëntë:	*Zhvillimi i projektit personal në linocut (koncept + realizim)*
Java e dhjetë:	*Kritikë dhe diskutim i ndërmjetëm i projekteve.*
***Java e njëmbedhjetë*:**	*Hyrje në grafikë digjitale – parimet, softuerët bazë, përgatitja e imazhit për print.*
***Java e dymbëdhjetë*:**	*Ndërthurja e teknikës tradicionale me atë digjitale (scan, manipulim, kompozim hibrid).*
***Java e trembëdhjetë*:**	*Zhvillimi i projektit digjital / projektit hibrid.*
***Java e katërmbëdhjetë*:**	*Përfundimi i projekteve finale (tradicionale ose digjitale).*
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	*Prezantim publik dhe vlerësim kritik i projekteve.*

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.